



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo


ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, me 24.02.2023

Për: Z. Nagip Krasniqi, Drejtor Menagjues, KEK SH.A

Nga: Z. Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së



Lënda: Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara gjatë shit-blerjes së energjisë elektrik nga gjeneratori publik "Korporata Elektroenergjete e Kosovës" (KEK SH.A.)

I nderuari z. Krasniqi,

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka përfunduar Raportin lidhur me shit-blerjes së energjisë elektrik nga gjeneratori publik "Korporata Elektroenergjete e Kosovës" (KEK SH.A.) i cili i është prezantuar Bordit të ZRRE në mbledhjen e datës 27.01.2023.

Bordi i ZRRE, pas shqyrtimit të Raportit dhe përgjigjet e pranuar nga KEK sh.a. ka nxjerrë Njoftimin mbi shkeljet e konstatuara e që kanë të bëjnë me shit-blerjen e energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Elektroenergjete e Kosovës" (KEK SH.A.), dhe në pajtim me nenin 57/7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ju njofton se mund të përgjigjeni me shkrim për shkeljet e konstatuara, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të këtij Njoftimi.

Bashkëlidhur me këtë shkresë gjeni edhe Njoftimin për shkeljet e konstatuara lidhur me shit-blerjen e energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Elektroenergjete e Kosovës" (KEK SH.A.).

Me respekt,

Në emër të Bordit të ZRRE

2023
Ymer Fejzullahu,
Kryesues i Bordit të ZRRE





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 janar 2023
Kodi i ZRRE-së: Nj_01_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në pajtueshmëri me dispozitat e Nenit 9, Nenin 16, Nenin 25, 28, par.1 dhe par. 2, Nenin 30, par.1, Nenin 55 par. 1, nënpar. 1.5, Nenin 56 par. 1 nënpar. 1.2, dhe Nenin 57 par. 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 7 par. 1 nënpar. 1.1, 1.2, 1.4 dhe 1.10, Nenin 22, par.5 dhe Nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, Nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, Nenin 2 par. 2, Nenin 8 par. 1, Nenin 9, Nenin 11 par. 10 dhe Nenin 12 par. 1 dhe 3, Nenin 13 par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike, Nenin 3, Nenin 4, Nenin 5, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 9 par. 6 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, Nenin 3, par 1 dhe 2, Nenin 13 dhe 24 të Licencës Nr. ZRRE/Libp_05/17_B dhe të Licencës Nr. ZRRE/Li_05/17_A për KEK SH.A., ka shqyrtuar komentet e "KEK" SH.A., ndaj Raportit të Monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK SH.A.), dhe në mbledhjen e mbajtur me 27 janar 2023 ka nxjerr këtë:

NJOFTIM

Lidhur me shkeljet e konstatuara gjatë shit-blerjes së energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës" (KEK SH.A.)

Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) në përputhje me kompetencat e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka bërë monitorimin e shit-blerjes së energjisë elektrike nga "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës" (KEK SH.A.)

Monitorimi ishte i fokusuar në mbledhjen, vlerësimin, analizimin dhe evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, dhënien e opinionit të pajtueshmërisë lidhur me tregtimin e energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike dhe nëse aspektet procedurale janë kryer në përputhje ose jo me dispozitat ligjore në fuqi.

Qëllimi i monitorimit ka përfshirë:

- Evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, mbi trajtimin e energjisë elektrike të prodhuar nga KEK SH.A., duke përfshirë importin, eksportin dhe shkëmbimin e energjisë elektrike me KESH. Qëllimi po ashtu ishte edhe vlerësimi pajtueshmërisë lidhur me tregtimin e energjisë elektrike, nëse në të gjitha aspektet procedurale të KEK SH.A., janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe kornizën rregullative në fuqi.

ZRRE, në kuadër të monitorimit të shit-blerjes së energjisë elektrike nga gjeneratori publik KEK SH.A ka përgatitur një Raport me të gjeturat të cilin ja ka prezantuar Bordit të ZRRE-së për shqyrtim.



Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 16 nëntor 2022, ka shqyrtuar të gjeturat në Raportin e përgatitur nga ekspertët e ZRRE-së dhe me 17 nëntor 2022 përmes dokumentit Raport i Monitorimit të shit-blerjes së energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK SH.A.), ka njoftuar palën lidhur me të gjeturat e monitorimit.

Po ashtu, Bordi i ZRRE-së, bazuar në Nenin 7 par. 2 të Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat, ka kërkuar nga "KEK" SHA. që në afat prej 15 ditë kalendarike të ofroj përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në Raport.

"KEK" SHA., me datë 02.12.2022 ka dërguar përgjigjet/komentet në Raportin e Monitorimit të shit-blerjes së energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK) të datës 16.11.2022, duke paraqitur përgjigjet në të gjeturat dhe konstatimet e evidentuara nga Raporti i Monitorimit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2023 ka shqyrtuar përgjigjet/komentet e dërguara nga "KEK" SH.A., ndaj Raportit të monitorimit të shit-blerjes së energjisë elektrike nga gjeneratori publik "Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK SH.A.), dhe ka konstatuar si në vijim:

- KEK SH.A., gjatë shit-blerjes së energjisë elektrike ka nënshkruar Kontrata Kornizë me shoqërit tregtare dhe degët e të cilëve nuk janë të regjistruara dhe të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas Parimit të Reciprocitetit.
- KEK SH.A., nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe Nenin 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nenin 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenin 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, Nenin 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.
- KEK SH.A., nuk e ka të aprovuar procedurën e brendshme të bazuar në funksionin e tyre në treg. Bazuar në këtë, tregtimi i energjisë elektrike pa procedurë të brendshme është në kundërshtim me Nenin 2, par. 2 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- KEK SH.A. ka përsëritur procesin e shtijes së energjisë elektrike edhe në raste kur ka pasur oferta Valide. Një veprim i tillë nga KEK SH.A. është në kundërshtim me Nenin 13, par. 1 i Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- KEK SH.A. gjatë përzgjedhjes së ofertave fituese nuk ka përdorur standard të njëjtë të përzgjedhjes në të gjitha rastet. Bazuar në këtë, përzgjedhja e ofertave fituese nuk është bërë në pajtim me Nenin 11 par. 10 dhe Nenin 12 par. 1 dhe 3 të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- KEK SH.A. duke shitur energji elektrike për KOSTT SH.A., për mbulimin e humbjeve në Veri të vendit, nën kushtet e marrëveshjes për mbulimin e humbjeve të sistemit ka vepruar në kundërshtim me Nenin 2 të Procedurës së Tregtimit të Energjisë Elektrike, pasi që në procedurë përcaktohet që tregtimi i energjisë elektrike duhet të i nënshtrohet tregut të lirë dhe konkurrues.



- KEK SH.A. – Gjenerimi ka nënshkruar marrëveshje për shitje të energjisë elektrike me KEK SH.A.– Furnizuesin për ofrimin e shërbimit të furnizuesit të mundësisë së fundit, duke mos ju nënshtruar kushteve të konkurrencës dhe procedurave të tenderimit. Bazuar në këtë, nënshkrimi i kontratës për shit-blerje të energjisë elektrike në këtë mënyrë, bie në kundërshtim me Nenin 22, par.5 të Ligjit për Energji Elektrike.

Andaj, bazuar në konstatimet e cekura më lartë, Bordi i ZRRE-së vlerëson se konstatimet e lartcekura janë bazë e mjaftueshme për aplikim e dispozitave ndëshkimore të përcaktuara me Nenit 57 paragrafi 2 nënpar. 2.8 dhe 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe Nenit 9 par. 1 nënpar. 1.8 dhe 1.14 të Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat, si dhe dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij njoftimi.

Bordi i ZRRE-së, në pajtim me dispozitat e Nenit 57 paragrafi 7 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, lëshon këtë **NJOFTIM**, me të cilin ju njofton se mund të përgjigjeni me shkrim për shkeljet e gjetura, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i këtij njoftimi.

Në emër të Bordit të ZRRE-së,

Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

